



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më 27/ 07/ 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare “Naim Frasheri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45000000-7 Punë ndërtimi

45214220-8 Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare

VLERA E FONDIT LIMIT: 53 276 944,17 (pesedhjetë e tre milion e dyqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e nentëqind e dyzet e kater presje shtatembedhjetë) **leke pa TVSH .**

Shënim:

Në bazë të shkresës nr.3124/5 prot date 09.06.2023 protokolluar prane Bashkis Fier me nr.5041prot date 12.06.2023 me lende “Dergohet celja e fondeve ne grupin e shpenzimeve kapitale per projektin me cikël fianancimi 2023-2024” nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiare ,Ministria e Arsimit dhe Sportit ,Urdheri i Ministris se Arsimit dhe Sportit me nr.3124/1 prot date 15.05.2023 ,me nr.237,date 15.05.2023 “Per shperndarjen e financimit per projekte te reja me cikël financimi 2023-2024,nga programet “Arsimi Baze” dhe “Arsimi Mesem”,per infrastrukturen shkolle” si dhe shkrese nr 9069/1 prot date 07.06.2023 me lende “Trasferim fondi per shpenzime kapitale” ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit te Investimeve Publike ,Ministria e Finacave dhe Ekonomise , për financimin procedures të prokurimit publik me objekt “**Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare “Naim Frasheri”**”, objekti i prokurimit **do të kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë**, por financimi do te behet nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin dhe Bashkise Fier perkatesishte si me poshte:

Për vitin 2023 do të financohet në vlerën prej **32 828 325** (tridhjetë e dy milion e tetëqind e njezet e tete mijë e treqind e njezet e pese) **lekë me TVSH** ku financimi nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin eshte ne vleren **23 475 117** (njezet e tre milion e katerqind e shtatedhjete e pese mijë e njeqind e shtatembedhjete) **lekë me TVSH** dhe financimi nga Bashkia Fier eshte **9 353 208** (nente milion e treqind e pesedhjete e tre mijë e dyqind e tete) **leke me TVSH** ndërsa pjesa tjetër e kontratës do të financohet **në vitin buxhetor 2024**, në vleren **31 104 008** (tridhjetë e nje milion e njeqind e kater mijë e tete) **lekë me TVSH** ku financimi nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin eshte ne vleren **23 475 117** (njezet e tre milion e katerqind e shtatedhjete e pese mijë e njeqind e shtatembedhjete) **lekë me TVSH** dhe financimi nga Bashkia Fier eshte **7 628 891** (shtate milion e gjashteqind e njezet e tete mijë e tetëqind e nentedhjete e nje) **leke me TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier, njesia e prokurimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMI

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si edhe ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per

auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, vlerë jo me pak se **30 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/b: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose*

lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e ketij kriterit të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e 2 (dy) viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale / Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:
 - 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:
 - 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 - 4. Aktin e kolaudimit;
 - 5. Fatura tatimore përfundimtare.

Ne rastin e paraqitjes se ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar).

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalish sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit,

që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor kërkon kontrate të ngjashme në vlerë 50 % të vlerës së fondit limit për një objekt të vetëm, *ose* punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*), pasi vlera e parashikuar e kontratës është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të realizuar punën sic është parashikuar nga AK. Vlera për punët të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, dhe kualifikuar për këto punime.

a) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinieret e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndertimi (si drejtues teknik) 1 (një);
2. Inxhinier Elektrik (si drejtues teknik) 1 (një);
3. Inxhinier Hidroteknik (si drejtues teknik) 1 (një);

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin **Qershor 2023**.

Për inxhinierin e sipërcituar duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme).

b) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës specialistë ndërtimi të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Inxhinier Elektronik/ Teknologji Informacioni/Telekomunikacion/
Inxhinier Informatike 1 (një)
- Inxhinier Topograf / Gjeodet 1 (një)

Për inxhinieret e sipërcituar duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme).

c) Operatori/ët ekonomik duhet te kete ne stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme të pakten **2 (dy) punonjes te certifikuar / te trajnuar**, per te kryer punime ne lartesi, sipas deshmive apo certifikatave te leshuara nga Institucione te certifikuar / akredituara ne Shqiperi ose nderkombetare.

Per punonjesit e sipercituar duhet të paraqitet deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër qe verteton diplomimin apo kualifikimin e tij, si dhe kontrate individuale e punës e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te zbatimit te punimeve

d) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates :

1 (një) pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, i cili të jetë i certifikuar me certifikatë/dëshmi si: “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Per punonjesit e sipercituar duhet të paraqitet deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër qe verteton diplomimin apo kualifikimin e tij, si dhe kontrate individuale e punës e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te zbatimit te punimeve

e) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates specialistë te certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:

- Teknik ndertimi 1(një);
- Ekskavatorist 1(një);
- Automakinist 2(dy);
- Muratore 2(dy);
- Hekurkthyes 2(dy);
- Karpentier 2(dy);
- Bojaxhi 2(dy);
- Suvatues 2(dy);
- Pllakashtrues 2(dy);
- Specialist durale 2(dy);
- Saldator 2(dy);
- Hidraulik 2(dy);
- Elektracist 2(dy);

Për specialistet e sipercituar sipas profesioneve duhet të paraqitet deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tij, si dhe kontrate individuale e punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Shënim: Për pikat **a)**, **b)**, **c)**, **d)** dhe **e)** me sipër, operatori/ët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)**, **b)**, **c)**, **d)** dhe **e)** të pikës **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i inxhinierëve të ndërtimit, elektrik, hidroteknik, elektronik dhe topograf/gjeodet është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Qershor 2023** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri i punonjësve (specialistë dhe punëtorë) është përcaktuar bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të

analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), në grafikun e punimeve, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **76 punonjës** duke përfshirë edhe stafin e perhershëm, për **muajin Qershor 2023**.

Shënim: Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetimi të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Qershor 2023**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Qershor 2023**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, në Kodin e Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregojnë besueshmëri për autoritetin. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë edhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri minimal i fuqisë punëtore (specialistë dhe puntori) të nevojshme për zbatimin e punimeve, referuar preventivit, grafikut të punimeve (**kater muaj**) si dhe duke punuar 5 ditë në javë, duhet të jetë **të paktën 76 punonjës** (duke përfshirë edhe drejtuesit teknik).

Numri i punonjësve (specialistë dhe puntori) është përcaktuar bazuar VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), në grafikun e punimeve, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën.

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Qershor 2023** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklaratimit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

2.3.4 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:**
 1. N.P. - 1/ Klasifikimi A (Punime gërmimi në tokë).
 2. N.P – 2/ Klasifikimi A (Ndërtime civile dhe industrial)
 3. N.P. –3/Klasifikimi A (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada).
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:**
 1. N.S. – 2 / Klasifikimi A (Impiante hidrosanitare,kuzhina,lavanderi,mirmbajtje e tyre)
 2. N.S. – 4 / Klasifikimi A (Punime rifinitur të muratës dhe të lidhura me to,rifinitur me material druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifinitur të natyrës Teknik e ndërtuese)
 3. N.S. – 8 / Klasifikimi A (Ndërtime parafabrikat betonarme,struktura metalike dhe druri)
 4. N.S. – 14 / Klasifikimi A (Impiante të brendshme ,elektrike,telefoni,radiotelefoni TV)

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008,”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, gjithashtu te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore". Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Me ane të këtij kriteri kërket që operatorët ekonomikë të deshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve ,objekt i kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e shërbimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P. - 1	Punime germimi ne toke	(Preventivi hidraulik (zeri me analize 3.89/a, 3.46/1) ;Preventivi konstruksioni I palestres (zeri me analize 2.26/a) ; Preventivi rikonstruksion I shkolles (zeri me analize 2.1)	A
N.P. - 2	Ndertime civile dhe industrial	Preventivi I konstruksionit te palestres (ndertimiri)	A

N.P. –3	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada).	Preventiviri konstruksioni I shkolles (godina e vjeter)	A
N.S. – 2	(Impiante hidrosanitare,kuzhina,lavanderi, mirmbajtje e tyre)	Preventivi Hidroteknik	A
N.S. – 4	(Punime rifiniturte muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese).	Preventivi rikonstruksioni I shkolles (zerat A/2 punime murature) ; preventivi I konstruksioni I palestres (zerat punime murature)	A
N.S. – 8	(Ndertime parafabrikat betonarme ,struktura metalike dhe druri)	Preventivi konstruksioni I palestres (zeri me analize 2.181), (kapriata))	A
N.S. – 14	(Impiante te brendeshme ,elektrike,telefoni,radiotelefoni TV)	Preventivi elektrik dhe elektronik	A

Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorine respektive eshte kerkuar A pasi vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventive eshte brenda vleres 20 (njzet) million lekë pa tvsh.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion:

a) Mjetet, makinerite dhe pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit*):

Nr.	Mjetet	Sasia	Statusi
1.	Betoniere 250 l	1 copë	Në pronësi ose me qera
2.	Elektroorgano	1 copë	Në pronësi ose me qera

3.	Elektrosaldatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
4.	Gazogjen	1 copë	Në pronësi ose me qera
5.	Vinc ekskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
6.	Pompe suvatimi	2 copë	Në pronësi ose me qera
7.	Autovinc me peshe ngritese min. 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
8.	Vibrator	2 copë	Në pronësi ose me qera
9.	Auto vetshkarkuese min. 5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
10.	Ekskavator me goma, me kove 0.25m3	2 copë	Në pronësi ose me qera
11.	Skele metalike	3000 m2	Në pronësi ose me qera
12.	Gjenerator min. 30 kw	1 copë	Në pronësi ose me qera
13.	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
14.	Trapan elektrik	2 copë	Në pronësi ose me qera
15.	Depozit uji min 5000 l	1 copë	Në pronësi ose me qera
16.	Tokmak elektrik	1 copë	Në pronësi ose me qera

b) Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), te nevojshme per sigurimin teknik ne kantier referuar legjislacionit ne fuqi, *(sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit)* duke perfshire minimumi edhe:

- Kokore, minimumi 30 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 3 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 3 copë.
- Veshje trupi me rripa sigurie ose litare sigurimi, per punimet ne lartesi, minimumi 20 cope.

Shënim: Për pikën **2.3.5 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 (a dhe b)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerases, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.**
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me **Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme)**, leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Argumentimi Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurte të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kerkuara në këto kërkesa për kualifikim, bazohet edhe në nevojën e disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitetet teknik si

per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrethana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundesive te manovrimit me mjete te renda. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve, sipas tabelës me poshte.

Kerkesat per makinerite/mjetet qe nevojiten argumentohet ne baze te zerave te preventivit:

NR	EMERTIMI I MAKINERISE	NR I MAKINERIVE	MANOVRATOR /SHOFER	SHENIME
1	Betoniere 250 l	1	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles(A/3 punime shtresash, nr8, An, shtrese betoni e lehtësuar per nivelim).
2	Elektroorgano	1	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles(A/3 punime shtresash, nr 9 dhe 10 hidroizolime), (A/6 punime taracash, nr 9 dhe 10 hidroizolime),(A/5 Punime fasade nr4) ; Palestra e shkolles (punime shtresash , nr 6 dhe 8, Punime fasade nr 4, punime tarace nr8.
3	Elektrosaldatrice	1	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles (punime te brendshme ndertimore zeri me analize 2.182 dhe 2.181); Preventivi konstruksioni I palestres zeri me analize 2.181.Preventivi hidroteknik,punime rrethimi zeri 2.182
4	Gazogjen	1	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles (punime te brendshme ndertimore zeri me analize 2.182, 2.181); Preventivi konstruksioni I palestres zeri me analize 2.181.Preventivi hidroteknik,punime rrethimi zeri 2.182
5	Vinc ekskavator	1	Ekskavatorist	Preventivi rikonstruksioni i shkolles (

				punime te brendshme ndertimore zeri me analize 2.182 dhe 2.181); Preventivi konstruksioni I palestres zeri me analize 2.181.Preventivi hidroteknik,punime rrethimi zeri 2.182
6	Pompe suvatimi	2	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles (punime te brendshme ndertimore zeri me analize 2.310); Preventivi i palestres(punime te brendshme ndertimore zeri me analize 2.310/1 dhe 2.314).
7	Autovinc me peshe ngritese min. 10 ton	1	Automakinist	Preventivi hidraulik, punime rrethimi me ze nr 2.182,(furnizim uji zeri me analize2.262,analiza nr 11) ; Preventivi rikonstruksion I shkolles (punime murature dhe betoni zeri me nr 2,3,4,5, punime shtresash zeri me nr 1,3,4,5,7, punime te brendshme ndertimore zeri me nr 2,3,11,12,13,16, punime fasade zeri me nr 5, punime tarace zeri me nr 4,6,8,11, punime pandusi zeri me nr 4,5,6); preventivi palestra(punime murature zeri me nr 1, 2 , punime shtresash zeri me nr 1,3,4,5,7, punime te brendshme ndertimore zeri me nr 2,3,4, punime tarace zeri me nr 3,7,5,10); preventivi palestra konstruksioni (zeri me nr 1,2,8,9,10,11,13).
8	Vibrator	2	-	Preventivi palestra konstruksioni(zeri me nr1,2,3,4,5,6,7,11);preventive rikonstruksioni (punime murature dhe betoni zeri me nr 1, punime te brendshme ndertimore zeri me nr 10 dhe 15, punime pandusi zeri me nr 2); preventivi hidrauliz(zeri me analize an22 dhe an 19) dhe te punime rrethimi zeri me nr 2.109/2.
9	Auto vetshkarkuese min. 5 ton	2	Automakinist	Preventivi hidraulik(furnizim me uje zeri me 2.258 dhe kanalizimet me uji zeri me analize 2.37/a , 2.261); preventivi rikonstruksioni I shkolles (zeri me analize 2.37/5a). Preveventivi kostruksioni I palestres zeri me nr 2.258, 2.19, 2.37/3b
10	Ekskavator me goma,me kove 0.25m3	1	Ekskavatorist	Preventivi palestra konstruksioni (zeri me analize2.26/a,;preventivi hidraulik(zeri me nr analize 3.89/a dhe 3.46/1 te furnizimi dhe zeri me analize3.89/a te kanalizimet).

11	Skele metalike	3000 m2	-	Kjo sasi skele eshte e nevojshme per kryerjen e punimeve ne afatin 4 mujor e specifikuar ne grafikun e punimeve, per 4 muaj per preventivin e rikonstruksionin te shkolles(godina e vjeter). dhe 2 muaj per punimet ndertimore te palestra.Kjo sasi mbulon nevojat per skele per preventivat e tjera me alternime.
12	Gjenerator min. 30 kw	1	-	Gjeneratori do te perdoret per furnizim me energji elektrike gjate kohes qe do te shkeputet lidhja me energjine elektrike ne shkolle per shkak te punimeve elektrike,per ndricimin ne oborr, per saldim etj.
13	Matrapik	2	-	Preventivi rikonstruksioni i shkolles(zerat e punimeve te prishjeve).
14	Trapan elektrik	2	-	Preventivi hidraulik (furnizim me uji zeri me analize AN-16 dhe AN-17 dhe analiza e montimit te pompes), Preventivi palestra (punime fasade zeri me analize 2.358/b); preventivi rikonstruksioni I shkolles (zeri me analize 2.358/b te punime fasade).
15	Depozit uji min 5000 l	1	-	Dopozita e ujit do te perdoret per depozitim e ujit per furnizim me uje ne menyre te vazhduar per pregatitjen e llacit, per suvatim, per lagien e betonit pas hedhjes se tij ne ne objekt,per nevojat personale gjate kohes se punes ne kantier etj.
16	Tokmak elektrik	1	-	Preventivi konstruksioni I palestres zeri me nr 3.47/1a

Shenim: *Perllogaritja e fuqise punetore dhe makinerive eshte bere bazuar neVKM Nr.629 dt.15/07/2015 " Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe analizave teknike te tyre". Ne shumicen e zerave te manualit te ndertimit ka ne analize*

perdorimin e vincit kulle me peshe ngritese 2.5 ton, 5-10 ton...Mqs ne projekt nuk eshte parashikuar ndertimi i bazamentit per ndertimin e vincit kulle ne objekt eshte menduar se per realizimin e punimeve ne objekt do te perdoret autovinc me peshe ngritese min.10 ton i cili duhet te rri i stacionuar ne objekt nga dita e pare deri ne ditën e fundit te mbylljes se punimeve.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet te paraqes certifikaten e cilesise se punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- **ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise) ose ekuivalent;**
- **ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit) ose ekuivalent;**
- **ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune) ose ekuivalent;**

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Referuar natyrës së punimeve, përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të mjedisit, menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).\

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, relacioni teknik,projekti, grafiku i punimeve dhe preventivi i zbatimit te punimeve jane hartuar nga Drejtoria e Projekteve te infrastruktures me shkrese nr.5300 datë 19.06.2023 dhe gjenden bashkengjitur DST ne SPE.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga specialisti i fushes pjese e njesise se prokurimit, duke u bazuar ne projektin, preventivin dhe grafikun e punimeve te objektit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Referimet ku në specifikime/relacion teknik, preventiv, dokumenta bashkelidhur DST ne SPE mund te jene përmendur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , shoqërohen me fjalën “**ose ekuivalente**”.

Njësia e prokurimit: